

**Voltalia Albanie sh.p.k**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022**

**Përmbajtja:**

Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare.....	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5-16

**VOLTALIA ALBANIE SHPK**

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>Aktivet</b>			
Kosto të kapitalizuara	6	13,607,193	2,284,017
Paisje, mobilje zyre dhe të tjera	6	14,783,392	1,335,943
<b>Aktive afatgjata</b>		<b>28,390,585</b>	<b>3,619,960</b>
Inventar	7	-	2,323,109
Punime në proces	8	158,768,877	73,044,306
Parapagime dhe aktive të tjera	9	242,183,293	13,985,860
Llogari të arkëtueshme	10	1,338,698,670	-
Mjete monetare dhe të tjere ekuivalente	11	158,025,936	10,675,860
<b>Aktivet afatshkurtra</b>		<b>1,897,676,776</b>	<b>100,029,135</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,926,067,361</b>	<b>103,649,095</b>
<b>Kapitali neto</b>			
Kapitali themeltar	5	100,000	100,000
Humbje e akumuluar		(7,706,963)	-
Fitimi/(humbja) e vitit	20	63,065,491	(7,706,963)
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>55,458,528</b>	<b>(7,606,963)</b>
<b>Detyrimet</b>			
Hua me palët e lidhura	11	1,165,580,256	81,828,654
<b>Detyrimet afatgjata</b>		<b>1,165,580,256</b>	<b>81,828,654</b>
Tatim fitimi i pagueshëm	13	19,371,484	-
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	12	685,657,093	29,427,404
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>705,028,577</b>	<b>29,427,404</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,870,608,833</b>	<b>111,256,058</b>
<b>Total i detyrimeve dhe kapitalit neto</b>		<b>1,926,067,361</b>	<b>103,649,095</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 17 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**VOLTALIA ALBANIE SHPK**

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të tjera Gjithpërfshirëse

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënimi	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
<b>Të ardhura të veprimtarisë</b>			
Të ardhura nga ndërtimi	14	562,071,282	-
Kosto e ndërtimit	15	(379,194,718)	-
<b>Fitimi bruto</b>		<b>182,876,564</b>	-
<b>Shpenzime të veprimtarisë</b>			
Shpenzime personeli	16	(23,914,031)	(4,187,201)
Amortizimi	6	(1,414,784)	(10,256)
Shpenzime operative	17	(84,316,833)	(1,867,746)
<b>Fitimi / (humbja) operative</b>		<b>(109,645,648)</b>	<b>(6,065,203)</b>
Shpenzime interesi	18	(20,149,897)	(2,062,822)
Humbje financiare, neto	19	29,355,956	421,062
<b>Shpenzime financiare, neto</b>		<b>9,206,059</b>	<b>(1,641,760)</b>
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>82,436,975</b>	<b>(7,706,963)</b>
Tatimi mbi fitimin		(19,371,484)	-
<b>Fitimi / (humbja) neto i vitit</b>	<b>20</b>	<b>63,065,491</b>	<b>(7,706,963)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, pas tatimit		-	-
<b>Totali i të ardhurave / (humbjes) gjithpërfshirëse të vitit</b>		<b>63,065,491</b>	<b>(7,706,963)</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 17 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**VOLTALIA ALBANIE SHPK**

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënimi	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2021
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		
Fitimi/(Humbja) neto për vitin	16	63,065,491 (7,706,963)
Rregullime për:		
Amortizimin	6	1,414,784 24,321
Kapitali i nënshkruar i papaguar	5	- 100,000
Shpenzime për interesa	14	18,087,074 2,062,822
<b>Fitimi/ (humbja) operative nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>82,567,349 (5,519,820)</b>
<i>Ndryshime në kapitalin punues:</i>		
Pakësim/(rritje) në kërkesa për t'u arkëtuar		(1,566,896,101) (13,985,860)
(Rritje)/ pakësim në inventar		2,323,108 (2,323,108)
Rritje/(Pakesim) në detyrime për t'u paguar		656,229,689 29,427,404
Rritje/(Pakesim) në punime ne proces		(85,724,571)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>(911,500,526) 7,598,615</b>
Tatim mbi fitimin i paguar		19,371,484 -
<b>Mjetet monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>(892,129,041) 7,598,615</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata	6	(26,185,409) (76,688,587)
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>		<b>(26,185,409) (76,688,587)</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Huamarrje		1,065,664,527 79,765,832
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese</b>		<b>1,065,664,527 79,765,832</b>
RRITJA (RËNIA) NETO E MJETEVE MONETARE		147,350,076 10,675,860
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		10,675,860 -
<b>MJETET MONETARE NË FUND TË PERIUdhËS KONTABEL</b>		<b>158,025,936 10,675,860</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 17 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapital themeltar	Fitim / (Humbja) e pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 3 shkurt 2021</b>	<b>100,000</b>		<b>100,000</b>
Fitimi/(Humbja) e vitit		(7,706,963)	(7,706,963)
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>100,000</b>	<b>(7,706,963)</b>	<b>(7,606,963)</b>
Fitimi/(Humbja) e vitit	-	63,065,491	63,065,491
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>100,000</b>	<b>55,358,528</b>	<b>55,358,528</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 17 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Administratori i Voltalia Albanie sh.p.k. më 30 maj 2023

**Bertrand Pierre Francis Tournier**

Administrator



**PwC Consulting Shpk**

Hartuesi



# VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

VOLTALIA ALBANIE (më poshtë referuar si 'Shoqëria') është themeluar më 26 janar 2021, me NIPT M11403024T. Shoqëria ka ortak të vetëm, shoqërinë VOLTALIA SA.

Shoqëria ka pjesë të aktivitetit të saj studimin, projektimin, furnizimin, ndërtimin, instalimin, përmirësimin, dhe mirëmbajtjen e impianteve të energjisë së rinovueshme dhe të njësive për ruajtjen e energjisë si dhe infrastrukturës së lidhur me të.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është Rr. Bajram Curri, Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 9, Zyra Nr.3, Njësia Administrative Nr.2, 1000, Tiranë.

Administratorët e Shoqërisë janë Joao Manuel Da Silva Boavida Malcata, Gustavo Manuel Ferreira Fernandes dhe Henri François Prat.

Shoqëria ka patur 21 punonjës më 31 dhjetor 2022 (2021: 7).

## 2. BAZA E KONTABILITETIT

Përgatitja e pasqyrave financiare është në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të).

### 2.1 PARIMI I VIJMËSISË

Drejtimi beson se Shoqëria do vazhdojë të realizojë fitime në të ardhmen dhe nuk do të çenohet parimi i vijmësisë. Ndaj, Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra financiare bazuar në parimin e vijmësisë.

## 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

### 3.1. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

### 3.2. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë shqiptar (Lekë), që është dhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

#### (a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve ose datën e vlerësimit në rastin e rimarrjes së zërave. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitime ose humbje. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse si "Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit, neto".

### 3.3. Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale

#### i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar apo zhvlerësimin.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribuueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjatë materiale.

**3.3. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)***ii. Kostot e zëvendësimit*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën neto të zërit nëse është e mundur që kosto e pjesës dhe përfitimet e ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese mund të maten me besueshmëri. Kostot e riparimit dhe mirëmbajtjes njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese. Fitimi ose humbja nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen si diferenca mes shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktivitetit (nëse ka) dhe vlerës kontabël (neto) të zërit.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto, duke filluar nga data e vënies në përdorim e aktivitetit (nëse vënia në përdorim nuk është e menjëhershme). Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura për kategoritë e aktiveve afatgjata materiale, si makineri e pajisje, automjete etj., paraqiten si me poshtë:

Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Kompjuter dhe pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mobilje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Përmirësime të pronës me qera	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Aktivitet afatgjata jomateriale	Mbi koston historike	15%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur për çdo kategori rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese.

**3.4. Aktivet financiare**

Shoqëria disponon vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbëra vetëm nga parapagime dhe të arkëtueshme të tjera, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të pagueshme, të tjera detyrime dhe detyrime ndaj ortakëve. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentet e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërsëdrejti me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Kompania vlerëson në fund të çdo periudhe raportuese nëse ka ndonjë evidence objektive që një aktiv financiar ose grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Nëse ekziston një evidence e tillë, Shoqëria mat humbjen nga zhvlerësimi si diferencë midis vlerës kontabël neto të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar. Shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të njësisë raportuese skadojnë, shfuqizohen ose anulohen. Diferenca midis vlerës kontabël të një pasivi financiar dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

**3.4. Aktivet financiare (vazhdim)**

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet me poshtë:

*a) Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë*

Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, depozitat dhe llogaritë rrjedhëse bankare si dhe investimet afatshkurta me likuiditet të lartë dhe me maturitet tre muaj ose më pak. Ato njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar

*b) Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogariten kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet në përputhje me termat kontraktuale të këtyre llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo vonesa në pagesa konsiderohen tregues për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*c) Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera*

Llogaritë e pagueshme dhe detyrime të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

**3.5. Zhvlerësimi**

Aktivitet me jetëgjatësi të papërcaktuar nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësime të mundshme.

Një aktiv testohet për zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivitetit.

Një humbje zhvlerësimi në lidhje me aktivin llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës së rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot për shitje ose vlera në përdorim e një aktivi, cilado qoftë më e lartë.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit aktivitet grupohen në grupet më të vogla të mundshme për të cilat flukset monetare identifikohen veçmas (njësi gjeneruese të parasë).

**3.6. Inventari**

Inventari paraqitet me vlerën më të vogël mes koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përbëhet nga kostot e materialeve direkte, punës direkte, kosto të tjera direkte dhe shpenzime të lidhura me prodhimin.

Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të bërë shitjen.

**3.7. Kapitali**

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

**3.8. Tatimi-fitimi dhe tatimi i shtyrë**

Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim-fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatim-fitimi i periudhës llogaritet sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

**3.8. Tatimi-fitimi dhe tatimi i shtyrë (vazhdim)**

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme.

Aktivet nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe atij të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe gjithashtu mundësinë e rritjes së detyrimit tatimor dhe interesave.

Shoqëria beson se njohja e detyrimeve fiskale është e përshtatshme për vitet në vazhdim pasi është bazuar në vlerësimin e një sërë faktorësh, përfshirë interpretimin e ligjit tatimor si dhe eksperiencat e mëparshme.

Ky vlerësim mbështetet në një sërë vlerësimesh dhe supozimesh që përfshijnë gjykime lidhur me ngjarje të ardhshme. Informacione të reja mund të shkaktojnë ndryshime në gjykimin e Shoqërisë lidhur me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; të tilla ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës në të cilën ndodhin

**3.9. Përfitimet e punonjësve**

*Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond të veçantë të menaxhuar nga qeveria. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

**3.10. Provizionet**

Provizionet për restaurime mjedisesh, kostot e ristrukturimit, detyrimet tatimore dhe pretendimet legale njihen nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, për të cilin do të kërkohen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij, dhe që shumica e këtyre flukseve llogaritet në mënyrë të besueshme. Nuk njihen provizione për humbje të ardhshme operative.

Kur ka një numër të madh detyrimesh të njëjta, probabiliteti që një fluks dalës të kërkohet për t'i shlyer përcaktohet duke e konsideruar klasën e detyrimeve si një të vetme. Një provizion njihet edhe kur ka të ngjarë që fluksi dalës për ndonjë nga zërat e së njëjtës klasë detyrimesh të jetë i vogël.

Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi. Provizionet rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe përshtaten për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Nëse përcaktohet se nuk do të kërkohen me burime ekonomike për të shlyer detyrimin, provizioni rimerret. Shuma e rimarrë njihet në fitim ose humbje.

**3.11. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të njësisë ekonomike që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet si dhe shitjet e eliminueshme brenda Shoqërisë, nëse ka.

**3.11. Njohja e të ardhurave (vazhdim)***(a) Të ardhurat nga interesat*

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kur një aktiv zhvlerësohet, Shoqëria redukton vlerën e mbartur të tij deri në vlerën e rikuperueshme, e cila është e barabartë me flukset e ardhshme të aktualizuara me normën efektive të interesit të instrumentit, dhe vazhdon të njohë shumën e skontuar si të ardhur nga interesi. Të ardhurat nga interesi në lidhje me huatë e zhvlerësuara njihen duke përdorur normën fillestare efektive të interesit.

*(b) Të ardhura të tjera*

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë përbëhen nga të ardhurat nga aktiviteti saj i zakonshëm (fitimet nga shitjet e aktiveve, të ardhurat nga qiratë operationale, kompensimet e marra për shpenzimet e bëra), të cilat njihen në periudhën të cilës ato i përkasin.

**4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR****4.1 Faktorët e riskut financiar**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj disa risqeve si: risku i tregut (përfshirë riskun e kurseve të këmbimit dhe riskun e normës së interesit), risku i kredisë dhe risku i likuiditetit. Programi i Shoqërisë për menaxhimin e përgjithshëm të riskut fokusohet në përcaktimin e kufijve të ekspozimit ndaj risqeve të ndryshme.

*a) Risku i tregut*

Risku i tregut është risku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmimet e tregut, kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive të ndryshimeve të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Shoqërisë.

*i. Risku i kurseve të këmbimit*

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me ekspozimet në monedhën Euro. Risku i kursit të këmbimit vjen kryesisht kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktivet dhe detyrimet janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë.

Shoqëria nuk mbrohet ndaj ekspozimit kundrejt riskut të kursit të këmbimit pasi nuk priten humbje të rëndësishme për shkak të ndryshueshmërisë në kurset e këmbimit krahasuar me kurset që mbizotërojnë në datën e raportimit.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 është si më poshtë:

<b>2022</b>	<b>EURO</b>	<b>LEKË</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente	154,069,810	3,956,127	158,025,936
Llogari të arkëtueshme	1,338,698,670	-	1,338,698,670
Parapagime dhe aktive të tjera	225,429,327	16,753,964	242,183,292
	<b>1,492,768,480</b>	<b>3,956,127</b>	<b>1,496,724,606</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	599,887,204	85,769,888	685,657,093
Hua nga palët e lidhura	1,165,580,256	-	1,165,580,256
Të pagueshme të tjera	-	19,371,484	19,371,484
	<b>1,765,467,460</b>	<b>105,141,373</b>	<b>1,870,608,833</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2022</b>	<b>(272,698,980)</b>	<b>(101,185,246)</b>	<b>(373,884,227)</b>

# VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## 4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

### 4.1 Faktorët e riskut financiar

2021	EURO	LEKË	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente	8,865,564	1,810,296	10,675,860
Llogari të arkëtueshme	-	13,985,860	13,985,860
	<b>8,865,564</b>	<b>15,796,156</b>	<b>24,661,720</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	-	29,427,404	29,427,404
Të pagueshme të tjera	81,828,654	-	81,828,654
	<b>81,828,654</b>	<b>29,427,404</b>	<b>111,256,058</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(72,963,090)</b>	<b>(13,631,248)</b>	<b>(86,594,338)</b>

Më poshtë paraqiten kurset e rëndësishme të këmbimit në Lekë për njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Lekë/EUR	114.23	120.76

Gjatë vitit kurset mesatare të këmbimit në Lekë për njësi të monedhës së huaj kanë qenë si më poshtë:

	2022	2021
Lekë/EUR	118.96	122.44

#### ii. Risku i normës së interesit

Të gjitha aktivet me interes të Shoqërisë kanë të bëjnë me llogaritë bankare. Të ardhurat dhe flukset monetare të Shoqërisë nuk janë të ekspozuara në mënyrë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit në treg. Shoqëria nuk ka detyrime që mbartin interesa dhe rrjedhimisht nuk përballet me riskun e normës së interesit në lidhje me detyrimet.

#### b) Risku i kredisë

Risku i kredisë është risku i humbjes financiare të shkaktuar nga dështimi i palës tjetër për të shlyer detyrimet e saj financiare kundrejt Shoqërisë dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

#### Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përbëhen nga kërkesat për t'u arkëtuar nga klientët e saj. Vlera e mbetur e aktiveve financiare përfaqëson riskun maksimal të kreditit. Risku maksimal i kreditit në datën e raportimit është:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	158,025,936	10,675,860
Llogari të arkëtueshme	1,580,881,962	13,985,860
<b>Totali</b>	<b>1,738,907,898</b>	<b>24,661,720</b>

#### c) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit përkufizohet si risku që njësi të hasë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të veta financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë, kryesisht për të shlyer shpenzimet operative për aktivitetin e saj të zakonshëm. Menaxhimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke përditësuar parashikimet e flukseve të parasë së Shoqërisë.

## VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 4. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim) c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare të Shoqërisë sipas niveleve të maturimit bazuar në periudhën e mbetur të raportimit deri në datën kontraktuale të maturimit:

2022	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
<b>Aktivet financiare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente	158,025,936	-	-	158,025,936
Llogari të arkëtueshme	1,338,698,670	-	-	1,338,698,670
Parapagime dhe aktive të tjera	242,083,292	100,000	-	242,183,292
	<b>1,738,807,898</b>	<b>100,000</b>	-	<b>1,738,907,898</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	685,657,093	-	-	685,657,093
Hua nga palet e lidhura	-	-	1,165,580,256	1,165,580,256
Tatim fitim i pagueshem	19,371,484	-	-	19,371,484
	<b>705,028,577</b>	-	<b>1,165,580,256</b>	<b>1,870,608,833</b>
<b>Totali i riskut të likuiditetit më 31 dhjetor 2022</b>	<b>1,033,779,321</b>	<b>100,000</b>	<b>(1,165,580,256)</b>	<b>(131,700,935)</b>

2021	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Totali
<b>Aktivet financiare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente	10,675,860	-	-	10,675,860
Llogari të arkëtueshme	13,985,860	-	-	13,985,860
Inventar	2,323,108	-	-	2,323,108
	<b>26,984,829</b>	-	-	<b>26,984,829</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	29,427,404	-	-	29,427,404
	<b>29,427,404</b>	-	-	<b>29,427,404</b>
<b>Totali i riskut të likuiditetit më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(2,442,575)</b>	-	-	<b>(2,442,575)</b>

### 5. Kapitali themeltar

Kapitali përbëhet nga 1 kuotë në vlerën 100,000 Lekë, të zotëruar nga shoqëria e huaj "VOLTALIA SA".



## VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 6. Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale

Aktivitet afatgjata përbëhen nga paisje dhe shpenzimet e kapitalizuara.

Ato paraqiten si më poshtë:

Kosto	Paisje informatike	Mjete transporti	Mobilje, paisje zyre dhe të tjera	Përmirësime të ambjenteve me qira	Punime në proces	Totali
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	-	-	-	-	-	-
Shtesa	554,279		805,985		75,328,323	76,688,587
Riklasifikime					(73,044,306)	(73,044,306)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>554,279</b>	<b>-</b>	<b>805,985</b>	<b>-</b>	<b>2,284,017</b>	<b>3,644,281</b>
Shtesa	3,139,465	7,795,249	2,205,612	1,721,906	11,323,176	26,185,409
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>3,693,745</b>	<b>7,795,249</b>	<b>3,011,597</b>	<b>1,721,906</b>	<b>13,607,193</b>	<b>29,829,690</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(10,193)</b>	<b>-</b>	<b>(14,128)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(24,321)</b>
Shpenzimi i vitit	(411,473)	(519,679)	(420,324)	(63,307)	-	(1,414,784)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>(421,666)</b>	<b>(519,679)</b>	<b>(434,452)</b>	<b>(63,307)</b>	<b>-</b>	<b>(1,439,105)</b>
<b>Vlera e mbartur</b>						
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>544,086</b>	<b>-</b>	<b>791,857</b>	<b>-</b>	<b>2,284,017</b>	<b>3,619,960</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>3,272,078</b>	<b>7,275,570</b>	<b>2,577,145</b>	<b>1,658,599</b>	<b>13,607,193</b>	<b>28,390,586</b>



# VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

## 7. Inventar

Gjendja e inventarit në fund të vitit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Inventar i mallrave për rishitje	-	2,323,108
<b>TOTALI</b>	<b>-</b>	<b>2,323,108</b>

## 8. Punime në proces – afatshkurtër

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Punime në proces –projekti Karavastasë	158,768,877	75,328,323
<b>TOTALI</b>	<b>158,768,877</b>	<b>75,328,323</b>

Punimet në proces paraqesin vlerën e punimeve në proces në impantin fotovoltaiik të Karavastasë, të cilat do të faturohen gjatë vitit 2023.

## 9. Parapagime dhe aktive të tjera

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Parapagime	242,080,589	2,103,125
Kapital i papaguar	100,000	100,000
Të tjera të arkëtueshme	2,704	-
TVSH e arkëtueshme	-	11,782,736
<b>TOTALI</b>	<b>242,183,293</b>	<b>13,985,860</b>

## 10. Llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogari të arkëtueshme me palë të lidhura	1,328,820,441	-
Llogari të arkëtueshme me të tretë	9,878,229	-
<b>TOTALI</b>	<b>1,338,698,670</b>	<b>-</b>

## 11. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Banka në Lekë	3,956,126	1,806,626
Banka në Euro	154,069,810	8,865,565
Mjete monetare në arkë	-	3,669
<b>TOTALI</b>	<b>158,025,936</b>	<b>10,675,860</b>

## 12. Hua me palët e lidhura

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Huamarrje nga Voltalia SA France	1,145,430,359	78,494,046
Interesa të pagueshëm ndaj Voltalia SA France	20,149,897	2,062,822
Të tjera të pagueshme kundrejt nga Voltalia SA	-	1,271,786
<b>TOTALI</b>	<b>1,165,580,256</b>	<b>81,828,654</b>

**VOLTALIA ALBANIE SHPK**

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**13. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Parapagime	556,758,912	-
TVSH e pagueshme	78,173,613	-
Llogari të pagueshme	32,982,629	26,389,025
Provigjone	11,011,886	-
Bonus i pagueshëm	4,158,600	1,421,859
Tatim mbi të ardhurat personale	1,176,265	360,951
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	910,079	246,153
Tatim në burim i pagueshëm	483,326	400,330
Paga të pagueshme	1,783	282,356
Të tjera të pagueshme	-	326,730
<b>TOTALI</b>	<b>685,657,093</b>	<b>29,427,404</b>

**14. Tatim fitimi i pagueshëm**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Tatim fitimi i pagueshëm	19,371,484	-
<b>TOTALI</b>	<b>19,371,484</b>	<b>-</b>

**15. Të ardhura nga ndërtimi**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Të ardhura nga ndërtimi	550,591,456	-
Të ardhura nga konsulenca	11,479,826	-
<b>TOTALI</b>	<b>562,071,282</b>	<b>-</b>

**16. Kosto e ndërtimit**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Kosto ndërtimi	379,194,718	-
<b>TOTALI</b>	<b>379,194,718</b>	<b>-</b>

**17. Shpenzime personeli**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Paga e kompesime	20,762,829	3,692,529
Shpenzime të sigurimeve shoqërore	1,859,852	390,806
Bonus për punonjësit	1,291,350	103,866
<b>TOTALI</b>	<b>23,914,031</b>	<b>4,187,201</b>

**VOLTALIA ALBANIE SHPK**

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**18. Shpenzime operative**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Shërbime ligjore	17,974,519	-
Shpenzime pritje përcjellje	14,753,050	470,490
Shërbime konsulence	13,270,972	-
Shpenzime qiraje	11,602,972	861,220
Shpenzime për garancitë e punimeve	11,011,886	-
Të tjera	5,775,701	15,440
Shpenzime sigurimi	3,800,593	40,509
Shpenzime transporti	2,703,245	-
Shërbime financiare dhe kontabël	2,044,013	181,600
Shpenzime administrimi dhe mirëmbajtje	456,731	51,927
Komisione bankare	399,225	88,223
Shpenzime internet dhe telefon	280,404	22,888
Riparime automjete	78,180	13,055
Tarifë anëtarësimi	65,422	41,541
Taksa, tarifa e kuota	57,159	29,922
Gjoha dhe penaltete	20,440	18,677
Shpenzime mirëmbajtje dhe materiale për zyrën	16,503	21,043
Tarifa të tjera	5,818	-
Shërbime nga të tretë	-	11,211
<b>TOTALI</b>	<b>84,316,833</b>	<b>1,867,746</b>

**19. Shpenzime interesi**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Shpenzim interesi për huanë nga Voltalia SA	20,149,897	2,062,822
<b>TOTALI</b>	<b>20,149,897</b>	<b>2,062,822</b>

**20. Të ardhura financiare, neto**

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Fitim/Humbje nga këmbimet valutore	(29,355,956)	(421,062)
<b>TOTALI</b>	<b>(29,355,956)</b>	<b>(421,062)</b>

**21. Tatimi fitimi**

Humbja tatimore e Shoqërisë për periudhën është llogaritur duke rregulluar humbjen kontabël me shpenzimet e panjohura, si vijon:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Fitimi/(Humbja) e vitit para tatimit	82,436,975	(7,706,963)
Shpenzime të pazbritshme	51,543,044	2,870,174
Humbja tatimore e mbartur	(4,836,789)	-
<b>Fitimi/(Humbja) i tatueshëm</b>	<b>129,143,230</b>	<b>(4,836,789)</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>19,371,484</b>	<b>-</b>

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 Shoqëria ka rezultuar me fitim të tatueshëm prej 129,143,230 Lekë.

## VOLTALIA ALBANIE SHPK

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 22. Palët e lidhura

Voltalia SA zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Veprimet dhe tepricat me Voltalia SA dhe filialet e saj, të cilat konsiderohen palë të lidhura, shfaqen në këtë shënim. Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë konsiderohet gjithashtu palë e lidhur.

#### Transaksionet me palët e lidhura – huatë e marra

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Huamarrje nga Voltalia SA France	1,145,430,359	78,494,046
Interesa të pagueshëm ndaj Voltalia SA France	20,149,897	2,062,822
Të tjera të pagueshme kundrejt nga Voltalia SA France	-	1,271,786
<b>TOTALI</b>	<b>1,165,580,256</b>	<b>81,828,654</b>

Shoqëria ka marrë hua nga mëma në vlerën 1,145,430,359 Lekë për të cilën janë llogaritur interesat sipas kontratës së huasë, në vlerën 20,149,897 Lekë.

#### Transaksionet me palët e lidhura – llogaritë e pagueshme

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Voltalia SA	8,497,455	-
Voltalia Greece SA	14,339,659	-
<b>TOTALI</b>	<b>22,837,114</b>	<b>-</b>

#### Transaksionet me palët e lidhura – llogaritë e arkëtueshme

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Karavasta Solar	560,071,282	-
<b>TOTALI</b>	<b>560,071,282</b>	<b>-</b>

#### Transaksionet me palët e lidhura – blerjet e inventarit

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Inventar i mallrave për rishitje	-	2,323,108
<b>TOTALI</b>	<b>-</b>	<b>2,323,108</b>

Voltalia Albania shpk ka blerë mallra për rishitje gjatë vitit 2021 nga shoqëria franceze "Distribution Voltalia SAS", pjesë e grupit, në vlerën 2,323,108 Lekë. Deri më datë 31.12.2021, e gjithë sasia e mallrave të blerë është gjendje inventari dhe është shitur gjatë vitit 2022.

Shpenzimet	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Blerje shërbime IT	3,843,643	-
Shërbimë studimi	14,339,659	-
Shërbime prokurimi	461,234	-
Blerje mallrash	2,441,256	-
Shpenzime interesi	20,149,897	-
	<b>41,235,689</b>	<b>-</b>

### 23. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera përveç sa më sipër, mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.